



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1668 / Prot
 11

Tiranë, më 01.09.2020

URDHËR

Nr. 213 / Datë 01.09 2020
 1 "PËR

**MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NGA NJËSITË E VETQEVERISJES
 VENDORE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË
 SHKAKTUAR NGA COVID-19 PËR APLIKUESIT DHE PËRFITUESIT E
 NDIHMËS EKONOMIKE"**

Mbështetur në nenin 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Ligjin nr. 10107 datë 30.03.2009, i ndryshuar "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 7 të ligjit nr. 57/2019 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri" si edhe Udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Aplikimet për ndihmë ekonomike do të realizohen sipas përcaktimit në Vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit, sipas përcaktimeve në këtë urdhër.
2. Punonjësit e njësisë së vetqeverisjes vendore pajisen me të gjitha mjetet mbrojtëse (maskë mbrojtëse për fytyrën, doreza për duart) dhe ruajnë distancën fizike 1.5-2 metër me qytetarët gjatë kryerjes së procedurave për aplikime, deklarime dhe verifikime të situatës social ekonomike në banesë. Në sportelet e aplikimit për ndihmë ekonomike vendoset mbrojtëse xhami.

3. Në hyrje të institucionit vendoset dezinfektant me bazë alkooli jo më pak se 60% për dezinfektimin e duarve.
 4. Pastrimi dhe dezinfektimi i të gjitha ambienteve do të kryhet rregullisht çdo ditë dhe pas çdo hyrje-dalje do të kryhet ajrosja e ambienteve, për jo më pak se 15 minuta, si edhe dezinfektimi i të gjitha sipërfaqeve, mjeteve të punës dhe dorezave të dyerve.
 5. Shmangen kontaktet me prekje dhe dhënia e duarve, shmanget prekja e fytyrës, gojës, hundës dhe syve dhe përdorimi i përbashkët apo shkëmbimi i sendeve personale.
 6. Për personat që paraqiten për aplikim realizohet matja e temperaturës nga personeli që është i pajisur me veshjen e përshtatshme sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
 7. Në ambientet e pritjes, respektohen rregullat e distancimit social, duke ruajtur distancën prej 1,5-2 m larg njëri-tjetrit, dhe merren masa për të evituar grumbullimet masive të tyre gjatë pritjes.
 8. Përpara hyrjes në institucion vendoset një shtrojë e lagur me klor / hipoklorit natriumi për të dezinfektuar këpucët dhe mjetet ndihmëse të personave me aftësi të kufizuar.
 9. Personat që paraqiten për aplikim duhet të jenë të pajisur me mjetet mbrojtëse (maskë mbrojtëse për fytyrën, doreza për duart).
 10. Respektimi rigoroz i masave të distancimit social, rregullave të higjienës, masave parandaluese, etj, nuk duhet të shkaktojë mundësi për diskriminim të personave që paraqiten për aplikim për ndihmë ekonomike, deklaram dhe gjatë kryerjes së verifikimeve social ekonomike.
 11. Në ambientet e njësisë të vetqeverisjes vendore vendosen postera ilustrues të afishuara, postera të larjes dhe dezinfektimit të duarve, si edhe afishohen rregullat e ndryshuara të cilat do të zbatohen për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.
 12. Urdhri nr. 213, datë 31.03.2020, shfuqizohet.
 13. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkitë.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Ogerta Manastirliu

